



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

---

**Intervistë e Ministrit Sadri Ferati dhënë të përditshmes “Epoka e re”**

**Sadri Ferati: T`a Fitojmë betejën me Beogradin**

Vështirësi kryesore jona është mosbesueshmëria e popullatës në terren

**Prishtinë , 22 maj 2008**

**EPOKA E RE:** *z. Ministër, ju udhëhiqni një ministri shume te rëndësishme për funksionimin e shtetit te Kosovës. Sa keni arritur të akomodoheni me punën tuaj?*

**Ferati:** Po, fillimisht unë jam shumë i kënaqur me gjendjen që e kam gjetur në ministri, e që është stabile. Puna ka vazhduar dhe jemi duke bërë përpjekje që ti ushtrojmë kompetencat tona në të gjithë fushat e përgjegjësive që i ka ministria, në bashkëpunim me të gjithë akterët relevantë që e ndihmojnë punën tonë, por edhe që e bëjnë të mundshëm realizimin e objektivave tona, qofshin ato të strukturave komunale, asociacionit të komunave, apo të nivelit qendror.

Jemi në realizimin e planit të punës, si dhe të prioriteteve që i kemi vënë në atë drejtim. Unë personalisht jam i kënaqur edhe me fushën e detyrave që ia kemi vënë vetes, por edhe me prioritetet të cilat vazhdojmë ti implementojmë.

**EPOKA E RE:** *Këto prioritete që po i përmendini, janë vazhdimësi e prioriteteve që i ka pasur ministria në mandatin e kaluar, apo janë prioritete që i keni vënë vet?*

**Ferati:** Ka edhe prioritete që janë vendosur me ardhjen tonë, por prioriteti kryesor që ka qenë dhe ndodhet prioritet, është reformimi i plotë i pushtetit lokal dhe decentralizimi. Këtë prioritet e kam gjetur si prioritet të ministrisë dhe vazhdojë ta implementoj si prioritet. Realisht ky është prioriteti numër një.

**EPOKA E RE:** *Cila është strategjia juaj për implementimin e këtij prioriteti?*

**Ferati:** Po pra, siç dihet në kohën e negociatave që i ka udhëhequr Presidenti Ahtisari është prodhuar një propozim, i cili është miratuar me shumicën dërmuese në parlamentin e Kosovës, dhe është marrë përsipër zotimi për ta implementuar atë propozim. Kështu që tash edhe ministria jonë, ka për detyrë ta implementojë atë dokument, që tash e tutje është dokument i institucioneve të Kosovës. Strategjia jonë është që ne, këtë çështje ta ngrisim në nivelin më të lartë, pra në

nivelin ndërministror. Është formuar grupi ndërministror për decentralizim. Unë, bashkë me zotin Pieter Feith, jemi bashkë kryesues të këtij grupi, po ashtu me vendimin e kabinetit qeveritar janë formuar edhe nëngrupet, ku bashkë kryesues janë, zyrtarë të lartë, zv.ministra dhe përfaqësues të ICO-së, por edhe përfaqësues të partive politike opozitare. Decentralizimi megjithatë është një punë me vëllim shumë të lartë që kërkon edhe një mbështetje dhe një konsensus që për fat të mirë ekziston momentalisht. Ne punojmë me dëshirën më të madhe që të bëjmë një rrugë dhe shumë punë, ngase edhe shtetet me një përvojë shumë të lartë të administrimit dhe qeverisjes, por edhe si shoqëri me më pak probleme se ne, kanë bërë vite të tëra për të implementuar vetë, një koncept paksa më të lehtë se decentralizimi. Fillimisht do ta implementojmë në aspektin e legjislacionit që tashmë veç se është aprovuar, do të thotë janë miratuar ligjet themelore; ligji për qeverisjen lokale, ligji për financat lokale dhe ligji për kufijtë administrativë. Pastaj do të bëhet implementimi i komunave të reja, ngritja e kapaciteteve dhe sigurimi i kompetencave shtesë që ju shkojnë tani komunave, përveç kompetencave që i kanë pasur deri më tash.

Decentralizimi ofron më shumë se të drejta të barabarta

**EPOKA E RE:** *Duke marrë parasysh tërë këtë angazhim, cilat janë pengesat kryesore me të cilat ju ballafaqoheni në kryerjen me sukses të këtyre pune?*

**Ferati:** Vështirësia kryesore është mosbesueshmëria e liderëve dhe e popullatës në terren. Do të thotë shqiptarët e kritikojnë, derisa serbët e refuzojnë këtë bashkëpunim, dhe kjo është pengesa dhe sfida kryesore që ne duhet ta fitojmë, që të mund ta implementojmë planin, ngase nuk kemi alternativa. Deri më tani institucionet e Kosovës kanë vetëm një dokument, dhe ai është dokumenti që e përmenda më herët, i cili na obligon që ne ta implementojmë këtë decentralizim të definuar ashtu siç e definojnë dokumenti.

**EPOKA E RE:** *Si parashihni ju ta eliminoni këtë pengesë?*

**Ferati:** Strategjia jonë është që të bëjmë përpjekje ta afirmojmë këtë projekt që ne mendojmë se është shumë i mirë, dhe është më i miri se të gjithë përvojat që janë në regjion dhe më gjerë, ngase fusha e kompetencave që u jepet komunave, sidomos atyre me shumicë serbe, është shumë më e gjerë. Më nuk diskutohet për të drejta për pakicat, ato janë të drejta të barabarta, bile edhe mund ti quajmë si një stimulim. Akoma në disa fusha, si në shëndetësi arsim dhe trashëgimi kulturore, komunat me shumicë serbe janë shumë më të fuqishme se sa komunat me shumicë shqiptare, prandaj strategjia jonë është që ne do ta afirmojmë këtë projekt, që serbët të shohin se me këtë decentralizim do të fitojnë më shumë se sa çdo qeverisje që e organizon vet Beogradit. Do të provojmë që sa më tepër të komprometojmë ndërhyrjen e Beogradit në format që momentalisht është duke ndërhyrë, pra përmes strukturave paralele. Serbët duhet ta kuptojnë se nuk kanë nevojë të udhëhiqen me struktura paralele, kur e kanë mundësinë ta qeverisin vetveten.

**EPOKA E RE:** *E dimë që serbët edhe pse të diskriminuar pozitivisht që nga pas lufta gjithmonë kanë qenë të prirur të mos bashkëpunojnë me institucionet e Kosovës. Çka nëse edhe në të ardhmen kur ju u jepni këto kompetenca ata edhe më tej nuk do bashkëpunojnë me ju?*

**Ferati:** Nuk është në detyrën e një ministri, në detyrën time konkretisht, ajo se çka duhet ti hiqet apo ti shtohet këtij plani. Ky është një vendim të cilin unë duhet ta zbatoj. Ne duhet të vazhdojmë ta afirmojmë dhe ta implementojmë te njerëzit, por nëse hapen pengesa të tilla madhore, atëherë marrja me ato pengesa është detyre e të gjitha institucioneve të Kosovës, e jo detyrë e vetëm një ministri. Kjo duhet të jetë me shumë veprime që të neutralizohet ndikimi i Beogradit, dhe të fuqizohet ndikimi i institucioneve të Kosovës. Faza e parë është që ne ta afirmojmë decentralizimin si një proces. Me këtë serbët ta kuptojnë se institucionet e Kosovës nuk janë të interesuar që të bëjnë asnjë veprim që ata i rrezikon në zhvillimin e identitetit të tyre kombëtarë, fetarë, kulturorë etj.. Tani për tani është numër shumë i vogël i serbëve që dëshiron, dhe që shoh interes të bashkëpunojë me ne, herë pas here është më i madh, herë pas here frikohen dhe tërhiqen. Dhe kjo është një betejë që ne duhet ta fitojmë. Dhe unë besoj se oferta jonë është serioze dhe shumë kualitative, dhe kjo na shtynë të besojmë se të gjithëve si shoqëri, përfshirë edhe serbët, edhe institucionet, edhe shoqëria civile edhe mediat, pra i gjithë potenciali i Kosovës, të orientohet në këtë drejtim dhe të besojmë se ne do ta fitojmë këtë betejë, dhe se

Beogradi e ka për përdorim ditor dhe për poena politik, nuk e ka shumë sinqerisht. Ne e kemi shumë sinqerisht dhe ne dëshirojmë, jemi të bindur dhe duhet ta fitojmë këtë betejë.

**EPOKA E RE:** *A është e vërtetë përshtypja e krijuar në opinion se procesi i decentralizimit i legalizon strukturat paralele serbe?*

**Ferati:** Unë prapë e them që për kualitetin e vet pakos, nuk kam kohë të bisedojë, për arsye se ai është një dokument i vendosur dhe unë e kam për detyrë ta implementojë. Por, po ashtu me një Kosovë funksionale, me një Kosovë të pavarur, të afirmuar ndërkombëtarisht dhe me një perspektiv në integrimet evropiane, unë mendoj se gjithçka që duket e rrezikshme nëse e komandon Beogradi, duket e parrezikshme nëse e komandon Kosova. Dhe, unë dua të besoj se Kosova do ta fitojë këtë betejë dhe kjo nuk do të dalë e rrezikshme për askë. Sepse pikërisht sot ne do të jemi më të interesuarit që të paraqiten se janë të kënaqur me të drejtat e tyre, se kanë të drejtë ti mbrojnë të drejtat e tyre. Por po ashtu nuk diskutohet që Kosova do të jetë vend ku kujtdo ti cenohet një i drejtë dhe ku do të zhvillohen sistemet paralele. Pikërisht decentralizimi është menduar, që do të jetë një mekanizëm për ti thyer këto strukturat paralele, për të integruar edhe pakicën serbe në këtë rast, dhe për të dëshmuar se Kosova është një shtet, që do të njeh të drejtat e barabarta për të gjithë.

**EPOKA E RE:** *Personalisht ju a mendoni se do thyhen këto struktura?*

**Ferati:** Unë do të punojë, dhe punojë me bindjen do të thyhen këto struktura paralele nëse kemi mbështetjen e gjithë institucioneve të Kosovës, edhe shoqërisë së gjerë.

**EPOKA E RE:** *Keni filluar me një kampanjë për ti informuar qytetarët për të mirat e decentralizimit. A mund të na thoni cilat janë ato?*

**Ferati:** Decentralizimi në Kosovë, është udhëheqë nga disa motive. E njohim Kosovën dhe e dimë se motiv nuk ka qenë vetëm zhvillimi ekonomik, nuk ka qenë veç qeverisja e mirë, por ka pasur edhe motive tjera. Pra bazuar në të gjitha motivet, edhe nëpër vendet që ka pasur më pak probleme, më pak motive, decentralizimi ka paraqitur një kohë, por gjithkund është synuar i njëjti rezultat që edhe ne e synojmë. Ajo është që të krijojë sa më shumë kompetenca për komunat në mënyrë që sa më shumë shërbime ti afrojmë afër qytetarit me politikën e subsidiaritetit qytetari ta prekë pushtetin, të krijojë një komunikim më të ngushtë me ata të cilët i ka zgjedhur vetë, përmes një adrese më të shkurtër. Çështja e dytë është që përveç fushës së kompetencave do të krijojmë një autonomi të fuqishme që kryetarët e komunave, që vërtet të kenë mundësi, kompetenca si dhe mbështetje financiare, prandaj është aprovuar ligji mbi financat lokale, që ti krijojnë të gjitha kushtet një kryetari të aftë, me një platformë dhe me një vizion shumë të qartë politikë, që me mbështetjen e legjislativës të asambleve komunale që ka, të mund të ndërtojë struktura ekzekutive, dhe ti ekzekutojë gjitha ato politika.

Vizita në Irlandën e Veriut

**EPOKA E RE:** *A do ti informoni ju qytetarët edhe për anët negative të decentralizimit?*

**Ferati:** Ne do ta prezantojmë decentralizimin në tersi, ashtu siç është. Unë do ta prezantoj decentralizimin në kuptimin e implementimit të tij, dhe qytetarët do të kenë të drejtë të komunikojnë dhe ta thonë mendimin e tyre. Dhe në këtë kontekst, unë kisha dëshiruar sa më tepër energji, që Kosovën ta dërgojmë nga fitorja e betejës me vetë Beogradin. Për decentralizimin është e paraparë një periudhë kohore pas tre vjetëve, kur ne do të analizojmë atë, ngase nuk përjashtohet asnjë mundësi. Unë, gjatë gjithë kontakteve dhe përvojave nëpër vende të tjera që kam pasur rastin ti vizitojë, por edhe gjatë takimeve me shumë autoritete ndërkombëtare, nuk kam vërejtur asnjëherë dilema për atë se, decentralizimi në Kosovë vërtet ofron diçka të mirë dhe të fuqishme. Ndoshta ekziston dilema se a janë të gatshme komunat tona të pranojnë aq shumë kompetenca. Pra unë do ta udhëheq një kampanjë dhe një decentralizim, që ka për qëllim ta fitojë betejën e parë me Beogradin, ti afirmojë institucionet e Kosovës dhe shoqërinë kosovare para faktorit ndërkombëtarë. Prapë po them. Fitorja më e madhe e implementimit të decentralizimit do të jetë fitorja me Beogradin dhe ky është qëllimi i parë i ynë. Nëse diçka ne e konsiderojmë që duhet ta riformulojmë, apo ti qasemi ndryshe, ne do ta bëjmë

një analizë pas dy apo tri vjetëve, siç është e paraparë, por tani për tani duhet të dihet; prioritet është fitorja e betejës me Beogradin dhe integrimi i Kosovës, integrimi i Mitrovicës, dhe integrimi i vlerave në shoqërinë tone.

**EPOKA E RE:** *A keni strategji të veçantë për implementimin e decentralizimit, dhe për integrimin e Mitrovicës?*

**Ferati:** Ne mendojmë se kjo strategji për implementimin e decentralizimit në përmasat dhe format siç po themi ne, do të jetë interes i vetë qytetarëve, në radhë të parë, edhe të serbëve, që të integrohet qyteti, sepse çdo zhvillim, kufizohet, fillon dhe përfundon me këtë parakusht. Cili është ai donatorë që do të gjuajë shumë mjete në një Mitrovicë të tensionuar? Cili është ai investitorë që do të vijë të investojë në një Mitrovicë të ndarë, të tensionuar dhe pretendente për eskalim situatë? Dhe çdo prodhim stabiliteti prodhon dy efekte; thithjen e mëtejme të donacioneve dhe sigurimin e investitorëve. Kjo është strategji de fakto është kulm është gjithçka. Se sa do të jetë i vështirë ky implementim, sa do të zgjatë eliminimi i të gjitha pasojave që i ka shkaktuar politika e Millosheviqit e dhe e pasardhësve të tij, nuk është në fuqinë tonë, dhe nuk do të mund të bëhet vetëm me dëshirën tonë. Ne do të përpiqemi maksimalisht të arrijmë të sigurojmë zbatimin e ligjit, lëvizjen e lirë, të drejtën e njerëzve të kenë qasje në pronat e tyre, të drejtën e njerëzve që të sigurojnë investime të balancuara, dhe mirëqenie sociale, unë mendojë që kjo është strategji mirë, dhe është rruga e parë që na dërgon në eliminimin e ndarjeve, dhe do të sigurojë që edhe vetë liderët dhe popullata serbe do të ndërtojë struktura në të cilët do të shtrijnë besimin, se tash e tutje ata do të udhëheqin me opsione reale.

**EPOKA E RE:** *z.Ministër para disa ditësh ishit në një vizitë punë në Irlandë. E vizituar këtë shtet për shkak të ekzistimit të disa ngjashmërive që ka Kosova me këtë vend apo..?*

**Ferati:** Po. Dëshira jonë është që vërtet të bashkëpunojmë me të gjithë faktorët që kanë përvojë në këtë drejtim. Irlanda Veriore konkretisht Belfasti, është një vend që po ashtu ka kaluar tensionime, dhe ne kemi një rezultat të përbashkët me ta, pavarësisht se këto dy kriza nuk përngjajnë për nga gjeneza e tyre, e ajo është humbja e besimit të bashkëjetesës dhe unë kam pasur dëshirë të shohë se cilat janë përpjekjet që bëhen atje, cilat janë dokumentet, cili është konsensusi politikë, çka bëhet që ai të implementohet, cilat janë rezultatet e pritshme dhe cila është dinamika që edhe ne ta besojmë. Dhe për kënaqësinë time kam parë që vërtet dokumentet tona janë në rrugë të mirë. Unë kam mësuar shumë atje dhe edhe në të ardhmen do të vazhdojë të sjellë përvoja nga të gjitha vendet e mundshme, me dëshirën më të mirë që ti kontribuoj sa më shumë Kosovës, dhe shoqërisë kosovare për të prodhuar ligje, vizione politike, bashkëpunime në tejkalimin e kësaj gjendje që vërtetë u është bërë e tepërt popullatës në tërësi.

**EPOKA E RE:** *Cili është profesioni i ministrit të administrimit të pushtetit lokal?*

**Ferati:** E kam të përfunduar fakultetin e teknologjisë. Në pamundësi që ta ushtrrojë deri në fund profesionin tim, kam bërë lëvizje në menagjment dhe ekonomi, ku kam udhëhequr një firmë të fuqishme, pastaj kam qenë drejtor i qendrës kulturës, po ashtu kam qenë kryeshef i kuvendit komunal ku kam krijuar përvojë të fuqishme me pushtetin lokal. Para luftës, kam qenë deputet, afro 30 vite kam përvojë në proceset politike, pra që prej vitit 81 dhe deri më tani.

Intervistoi  
Jetlir Zyberaj